



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**Psh. nr. 550/22**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 9 i "Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave", si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30. 09. 2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE "NB COMPANY" me seli në Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i kolektorit në Hajvali" me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 22 73511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 19 tetor 2022, mori këtë:

**VENDIM**

**Hedhet si e jashtafatshme**, ankesa e OE "NB COMPANY" me seli në Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i kolektorit në Hajvali" me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 22 73511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës.

**I lejohet**, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i kolektorit në Hajvali" me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 22 73511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik

ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale*

Autoriteti Kontraktues- Komuna e Prishtinës për aktivitetin e prokurimit :“Ndërtimi i kolektorit në Hajvali” me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 22 73511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, me datën 15.07.2022 ka publikuar Njoftimin për kontratë.

Me datën 29.09.2022 ka publikuar B58 Njoftimin për dhënie të kontratës me Letër Standarde.

Në sistemin e prokurimit figuron që OE ankues kërkesën për rishqyrtim e ka dorëzuar me datën 04.10.2022.

AK me datën 04.10.2022 ka marr vendim në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues dhe OE i pa kënaqur me këtë vendim me datën 14.10.2022 në ora 16:47 minuta parashtron ankesë në OSHP.

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vlerësohet se duke pas parasysh faktin se AK ka publikuar vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim 04.10.2022, afati ligjor për ankesë për OE ankues në Organi Shqyrtues të Prokurimit ka filluar të rrjedhë nga data 05.10.2022, duke filluar nga ora 08:00 deri në orën 16:00 dhe ky afat ligjor ka përfunduar me datën 14.10.2022 në ora 16:00.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

### **Kalkulimi i afateve kohore**

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE ankues ankesën me numër të protokollit 550/2022, e ka parashtruar në kundërshtim me neni 109 të LPP-së sepse neni 109 i LPP-së specifikon:

## Afatet për Dorëzimin e Ankesës

1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.
2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu edhe neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimin të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstatoj se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE “NB COMPANY” me seli në Obiliq, me numër te protokollit 550/2022, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kolektorit në Hajvali” me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1 dhe numër të brendshëm 616 22 73511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, hedhet si e jashtafatshme sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe neni 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimin të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lart e njëjta ankesë nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE“NB COMPANY” me seli në Obiliq
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së

  
Kryetarja e OSHP-së  
Vjosa Gradinaj Mexhuani